



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), neni 37.3, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 07.02.2020, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **ZNJ. MIMOZA STUBLLA-ABDULLAHU** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës -PDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Floretë Zejnullahu
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj. Floretë Zejnullahu dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 20.01.2020, Nr.51/2020, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Komunal znj. Floretë Zejnullahu, pas dorëheqjes së saj të përvokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës, për arsye të zgjedhjes deputete në Kuvendin e Kosovës, nga zgjedhjet e mbajtura më 6 tetor 2019.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidatja e radhës në listën e rirenditur është, znj. Mimoza Stublla-Abdullahu e cili ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidate e radhës, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 07.02.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

